



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2818/ 10 prot.

Datë 10.11.2025

V E N D I M
Nr. 1632/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.11.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.1513/2025, datë 22.10.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-59831-08-29-2025, me objekt: “Shërbime në lartësi me vinç (kosh te trupezuar) për ngritje personash dhe objektesh në lartësi 20 m”, me fond limit 3,641,666.67 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Dekorit dhe Eventeve Tirane

Ankimues: “Pastrime Silvio” SHPK me NIPT K91413010N dhe adresë: Njesia Bashkiake nr. 2, Rruga Fatmir Haxhiu, Pallati 2, Shkalla 10, Apartamenti 76, Kati I

Autoriteti Kontraktor: Ndërmarrja e Dekorit dhe Eventeve Tirane me adresë Rr. “Beqir Luga”, Tiranë

Subjekte të Interesuara: Teodor Goga P.F me L61605009T dhe adresë: Tirane, Njesia bashkiake nr 5, rruga Frang Bardhi, pallati Vala nr 1, shk C, kati 4

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit

Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 22.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.1513/2025, ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-59831-08-29-2025, me objekt: “Shërbime në lartësi me vinç (kosh te trapezuar) për ngritje personash dhe objektesh në lartësi 20 m”, me fond limit 3,641,666.67 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Dekorit dhe Eventeve Tirane.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik Teodor Goga P.F, duke e skualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.223/32 prot., datë 23.11.2025, me objekt “Njoftim mbi zbatim e Vendimit të Komisionit të Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar me tonën nr. 2818/7 prot., datë 05.11.2025, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 2818/2025 datë 22.10.2025.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr.223/32 prot., datë 23.11.2025, me objekt “Njoftim mbi zbatim e Vendimit të Komisionit të Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar me tonën nr. 2818/7 prot., datë 05.11.2025, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 2818/2025 datë 22.10.2025.

II.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës duke skualifikuar operatorin ekonomik Teodor Goga P.F në përputhje me konstatimet e KPP të shprehura në vendimin nr. 2818/7 prot., datë 05.11.2025.

II.3. Sa më sipër, konstatohet se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin nr. 2818/7 prot., datë 05.11.2025 të KPP-së për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-59831-08-29-2025, me objekt: “Shërbime në lartësi me vinç (kosh te trupezuar) për ngritje personash dhe objektsh ne lartesi 20 m”, me fond limit 3,641,666.67 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Dekorit dhe Eventeve Tirane.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur” me Nr. REF-59831-08-29-2025, me objekt: “Shërbime në lartësi me vinç (kosh te trupezuar) për ngritje personash dhe objektsh ne lartesi 20 m”, me fond limit 3,641,666.67 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Dekorit dhe Eventeve Tirane.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar	Anëtar	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anila Malaj	Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

